REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr._____Prot. Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr. 205, datë 20/10/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*[1], të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 126, datë 09.07.2021, të L.Xh. dhe A.K., përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës "Drejtësi Sociale", z. G. S., ku pretendohet diskriminim për shkak të *"etnisë"*[2] dhe *"përkatësisë në një grup të veçantë"* nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri – ASHK,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi[3],

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankuesit janë anëtarë të komunitetit egjiptian dhe banues në zonën "5 Maji" të qytetit të Tiranës, ku kanë ndërtuar objekte informale. Ata kanë plotësuar dhe dorëzuar vetëdeklarimet për legalizimin e këtyre objekteve informale në vitin 2006 pranë Drejtorisë së Aluizni-t Tirana Veri. Në vitin 2018, është miratuar Urdhëri nr. 163, datë 29.06.2018, i Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri, *"Për mospërfshirjen në proçesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. Artan Kruja",* i cili është përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 6708/1, datë 02.07.2018, në adresë të ankuesit Artan Kruja dhe për dijeni pranë Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Aluiznit. Referuar kësaj shkresë citohet se, nëpërmjet urdhërit të sipërpërmendur është

[1] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;
[2] Referuar vërtetimeve nr. 06.07.2021, të lëshuar nga Shoqata "T'REJA" rezulton se të dy ankuesit i përkasin komunitetit egjiptian;
[3] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al

vendosur mospërfshirja e ndërtimit në proçesin e legalizimit, pasi nga verifikimi i gjendjes aktuale të objektit, në referencë të proçesverbalit të datës 16.05.2018, ka rezultuar se ndërtimi është i paqëndrueshëm.

Njëkohësisht, në të njëjtin vit, është miratuar edhe Urdhëri nr. 170, datë 29.06.2018, i Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri, "*Për mospërfshirjen në proçesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. L. Xh.*", i cili është përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 6718/1, datë 02.07.2018, në adresë të ankuesit Luan Xhafa dhe për dijeni pranë Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Aluiznit. Referuar kësaj shkresë rezulton se, nëpërmjet urdhërit të sipërcituar është vendosur mospërfshirja e ndërtimit në proçesin e legalizimit, pasi nga verifikimi i gjendjes aktuale të objektit, në referencë të proçesverbalit të datës 25.05.2018, rezultoi se objekti ka funksion ndihmës dhe nuk ndodhet në parcelën ndërtimore të ndonjë ndërtimi informal me funksion kryesor. Në shkresë është cituar fakti se në bazë të nenit 2, pika 3 të ligjit 9482/2006 *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar, ndërtimi informal nuk përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit.

Të dy ankuesit pretendojnë se janë njohur me urdhërat dhe shkresat e sipërcituara në datën 01.07.2021, kur janë paraqitur tek Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, për t'u informuar mbi ecurinë e proçesit të legalizimit të objekteve informale të vetëdeklaruara, që në vitin 2006.

Aktualisht, zona ku ndodhen objektet informale e dy ankuesve është prekur nga Vendimi nr. 78, datë 31.01.2020, i Këshillit të Ministrave *"Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë 4 dhe 8, zona "5 Maji"*. Ata nuk përfitojnë të ardhura nga shpronësimi për interes publik, në funksion të akteve përkatëse nënligjore, pasi dy urdhërat e Drejtorisë së Aluizni-t Tirana Veri, i kanë përjashtuar nga proçesi i legalizimit.

Ankuesit pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë, pasi në zonën ku ata jetojnë ka edhe objekte të tjera informale në të njëjtat kushte, sikurse objektet e tyre, por ndaj tyre nuk është nxjerrë urdhër për mospërfshirje në proçesin e legalizimit. Ankuesit pretendojnë për një përzgjedhje të bërë në mënyrë selektive, e cila konsiston në faktin se ankuesit i përkasin komunitetit egjiptian.

II. Ndjekja e proçedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al

shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *"etnisë"* dhe *"përkatësisë në një grup të veçantë"*, duke përcaktuar se: "*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *"1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre."*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *"1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi."*

Hapat proçedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al

A. Pas analizimit të ankesës nr. 126, datë 09.07.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7[4], të ligjit nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Vendore Tirana Veri – ASHK, me shkresën nr. 1055/1, datë 26.07.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesve;
2. Urdhëri nr. 163, datë 29.06.2018, i Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri, *"Për mospërfshirjen në proçesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. Artan Kruja"* dhe shkresa nr. 6708/1, datë 02.07.2018, e Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri;
3. Urdhëri nr. 170, datë 29.06.2018, i Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri, "*Për mospërfshirjen në proçesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. Luan Xhafa*" dhe shkresa nr. 6718/1, datë 02.07.2018, e Drejtorit të Aluizni-t Tirana Veri;
4. Kopje të Lajmërim marrjeve ose të çdo akti tjetër, nëpërmjet së cilave vërtetohet se të dy ankuesit kanë marrë dijeni, brenda afatit ligjor, mbi urdhërat e shkresat e sipërcituara;
5. Proçesverbali i datës 25.05.2018, për objektin informal të deklaruar nga z. Luan Xhafa dhe proçesverbali i datës 16.05.2018, për objektin informal të deklaruar nga z. Artan Kruja;
6. Dokumentacioni provues mbi përjashtimin nga legalizimi të objekteve informale të të dy ankuesve;
7. Informacion sa prej banorëve të zonës "5 Maji" janë përjashtuar nga proçesi i legalizimit të objekteve informale të deklaruara, për arsye të njëjta apo të ngjashme me ato të ankuesve.

- Drejtoria Vendore Tirana Veri – ASHK nuk i ktheu përgjigje shkresës së KMD.

- Në këto kushte, KMD iu drejtua sërish Drejtorisë Vendore Tirana Veri – ASHK, nëpërmjet shkresës nr. 1055/2, datë 01.09.2021, ku i bën kujtesë për kthim përgjigje.

[4] Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *"Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër".*

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri – ASHK dërgoi shkresën nr. 8138/2, datë 07.09.2021, nëpërmjet së cilës bën me dije se nga verifikimi fizik i praktikës së legalizimit në dosjen e z. A. R. K. dhe përkatësisht relacionit të datës 28.06.2018, të mbajtur nga grupi i punës, rezulton se objekti informal është i paqëndrueshëm, me mbulesë llamarine. Ndodhur në këto kushte, Drejtoria Tiranë Veri ka dalë në vendimmarrje me anë të Udhërit nr. 163, datë 29.06.2018 *"Për mospërfshirje në procesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. Artan Ramazan Kruja"*.

Për praktikën e z. L. B. Xh. rezulton se nga verifikimi fizik i praktikës së legalizimit, në dosje administrohet relacioni i datës 28.06.2018. Sipas këtij relacioni të mbajtur nga grupi i punës citohet se objekti informal është me mbulesë të jashtme prej plasmasi. Ndodhur në këto kushte, Drejtoria Vendore Tiranë Veri ka dalë në vendimmarrje me anë të Urdhërit nr. 170, datë 29.06.2018 *"Për mospërfshirje në procesin e legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga z. Luan Bardhyl Xhafa"*.

- Në vijim të proçedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 07.10.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesja me autorizim e Drejtorisë Vendore Tirana Veri – ASHK. Përfaqësuesi i ankuesve nuk u paraqit në seancë dhe gjatë bashkëbisedimit në telefon me të në hapje të seancës, ai u shpreh se ankuesit tërhiqen nga ankesa e tyre, pasi vetëdeklarimet e tyre janë përfshirë në procedurat e legalizimit dhe qëllimi për të cilin është depozituar ankesa është arritur.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Drejtoria Vendore Tirana Veri – ASHK dërgoi në adresë të Komisionerit, shkresën nr. 1055/5, datë 14.10.2021, nëpërmjet së cilës njofton se Agjensia Shtetërore e Kadastrës mori masa për verifikimin e rastit të ankuesve Luan Xhafa dhe Artan Kruja dhe nëpërmjet shkresës nr. 17277 prot., datë 04.08.2021 dhe shkresës nr. 17278 prot., datë 04.08.2021, vijoi duke i përfshirë në procedurat e legalizimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

- Në datën 15.10.2021, përfaqësuesi ligjor i ankuesve iu drejtua KMD-së me e-mail, nëpërmjet së cilit njofton për tërheqjen e ankesës së tyre ndaj Drejtorisë Vendore Tirana Veri – ASHK, pasi është arritur qëllimi, për të cilin është filluar hetimi administrativ.

- Në këto kushte, Komisioneri gjykoi se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ku

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al

parashikohet: *"Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa"*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*[5], Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e proçedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 126, datë 09.07.2021, së L.Xh. dhe A.K., për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkak – etnia dhe përkatësi në grup të veçantë
Fusha – Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit – arritje qëllimi

[5] Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* parashikon: "*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë."*

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001,Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web:www.kmd.al